

VENDIM
Nr.267, datë 30.11.2011

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR ERGI”
SUBJEKTIT PERSON FIZIK: ERJON KETA

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit, person fizik z.Erjon Keta, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë, personit fizik z.Erjon Keta, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV kabllor Ergi”, për një periudhë prej 6-vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal fshatrat Rrashbull dhe Shënavlash.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati